



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER BELINDA V. ÇELAJ
ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI,
NR.3/118
TEL: 0692077776

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 120

Nr. koleksioni: 47


Tirane më 14/01/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025050310007235881



A2025050310007235881

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**(TË SHOQËRISË "IMPACTO COMMUNICATIONS" SH.P.K)**

Sot, më datë 14/01/2025, para meje Nötere BELINDA V. ÇELAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Nöterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.3/118, u paraqit personalisht:

SHITES:

Znj. Rezarta Bytyçi, shtetase shqiptare, lindur më 02.10.1987, në Kukës, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr. personal: I76020053C madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e **Ortakut**, në masën 100% të pjesëve të kapitalit, të Shoqërisë "IMPACTO COMMUNICATIONS" Shpk, e regjistruar në Tiranë, Shqipëri, me NIPT-M02202016S, me seli në adreseen: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati "Nord Konstruksion", Kati 5, Ap. 46, Tiranë

i quajtur më poshtë si "**Shitësi**",

BLERES:

Z. Sokol Meqemeja, shtetas shqiptar, lindur me 28.06.1969, në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtës i Pasaportës me Numër Personal: G90628152K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

i quajtur më poshtë si "**Blerësi**".

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Nöterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Nöterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "IMPACTO COMMUNICATIONS" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Nöterinë".


TË DHËNA PARAPRAKE

- A. **Znj. Rezarta Bytyçi** është pronare e 1 (një) kuote që përfaqëson 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë "IMPACTO COMMUNICATIONS" Shpk, kuotë e cila është e lirë nga çdo pretendim apo barrë në favor të të tretëve.



A2025050310007235881

- B. **Z. Sokol Meqemeja** është shtetas shqiptar, i cili ka shprehur interes për blerje të këtyre pjesëve të kapitalit të zotëruar nga Shitësi në këtë shoqëri.



NENI 1 OBJEKTI

- 1.1. Objekti i kësaj Kontrate Shitje është kalimi i pronësisë, kundrejt shpërblimit, i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë "Impacto Communications" Shpk, të zotëruara nga Ortaku i Vetëm **Znj. Rezarta Bytyçi**, në favor të **Blerësit Z. Sokol Meqemeja**.

NENI 2 ÇMIMI DHE PAGESA E TIJ

- 2.1. Çmimi total për shitblerjen e pjesës prej 100% (njëqind përqind) të kapitalit, do të jetë në vlerën nominale prej 100 (njëqind) Lekë dhe do të paguhet *Shitësit* jashtë kësaj zyre noteriale. Me nënshkrimin dhe legalizimin prej Noteres të kësaj Kontrate, Blerësi fiton pronësinë e plotë mbi 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit dhe ka të drejtën të depozitojë këtë Kontratë pranë QKB-së për pasqyrimin e kalimit në pronësi të tij të 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë.
- 2.2. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, situata e kuotave dhe pjesëve të kapitalit në Shoqëri do të jetë si vijon:
- a) **Sokol Meqemeja**, zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit.

NENI 3 DIJENI, PËRGJEGJËSI DHE GARANCI


- 3.1. Shitësi garanton *Blerësin* se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë dhe hipotekë, në përputhje me Vërtetimin përkatës të lëshuar nga Regjistri i Barrëve Siguruese.
- 3.2. *Blerësi* fiton nëpërmjet kësaj Kontrate të gjitha të drejtat që burojnë nga zotërimi i kuotës dhe i pjesëve të kapitalit.

NENI 4 TAKSAT DHE KONTRIBUTET

- 4.1. Çdo taksë apo tarifë e cila lidhet me kalimin e pronësisë së kuotave apo gjithçka tjetër që lind si rrjedhojë e përmbushjes së termave të kësaj Kontrate do të kryhet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

NENI 5 SHPENZIMET

- 5.1. Të gjitha shpenzimet në lidhje me këtë Kontratë, përfshirë kostot e Noterit Publik, do të paguhën nga *Blerësi*.



A2025050310007235881

NENI 6 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 6.1.** Kjo Kontratë do të interpretohet sipas Ligjit Shqiptar. Çfarëdo çështje e cila nuk parashikohet nga kjo Kontratë, do të zgjidhet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar.
- 6.2.** Në rast të ndonjë mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve dhe që ka të bëjë me interpretimin, zbatimin, përfundimin e kësaj Kontrate, Palët bien dakort të bëjnë maksimumin e mundshëm për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.
- 6.3.** Nëse pas përpjekjeve të arsyeshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë miqësore, zgjidhja nuk arrihet për 30 (tridhjetë) ditë nga tentativa e parë për zgjidhje miqësore, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet në rrugë gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 7 KONFIDENCIALITETI

- 7.1.** Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të përfshirë në këtë kontratë dhe të mos e kalojnë atë në asnjë formë tek të tretët.

NENI 8 ANEKSET E KONTRATËS

- 8.1.** Sikundër është përcaktuar edhe më lart në këtë Kontratë, Palët kanë detajuar në Aneke të posaçme të dhëna të nevojshme dhe të domosdoshme për qartësimin e Kontratës dhe të vetë marrëdhënies ndërmjet Palëve.
- 8.2.** Në të tilla kushte, këto Aneke do të jenë pjesë përbërëse dhe e pandashme e Kontratës, duke pasur të njëjtën fuqi ligjore për Palët ashtu si edhe vetë kjo Kontratë.
- 8.3.** Anekset e Kontratës janë:
- Vendimi i Asamblesë së Shoqërisë "Impacto Communications" Shpk datë 14.01.2025;
 - Ekstrakt nga QKB i Shoqërisë "Impacto Communications" Shpk;
 - Dokumentet e identifikimit të nënshkruesve.

NENI 9 TË NDRYSHME

- 9.1.** Kjo kontratë është përgatitur në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën Shqipe, nga një kopje prej të cilave i vendoset në dispozicion *Shitësit* dhe *Blerësit*, respektivisht, një kopje në arkivën e Shoqërisë dhe një kopje mbahet në Zyrën e Noterisë Tiranë.
- 9.2.** Kontrata hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të Kontratës nga Palët pjesmarrëse.

RB



A2025050310007235881

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara mejë Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.



Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALET:**SHITËSI****Znj. Rezarta Bytyçi**

Rezarta Bytyçi
RB

BLERËSI**Z. Sokol Meqemeja**

Sokol Meqemeja





Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com



REZULTATET E KERKIMIT


Numri i Rezultatit të kerkimit:	D-20250114165140248
Data e Rezultatit të Kerkimit:	14.01.2025
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	16:51:40
Lloji i Kerkimit:	Emri i Personit Juridik
Numri i Dokumentit:	D-400-608-4524

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

IMPACTO COMMUNICATIONS SH.P.K.

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



SUBJEKTI KERKUES:

Emertimi
ANILA ISUF CELAJ P.F.

Bayamela Lala

TE DHENAT E PERDORUESIT:

Emri dhe Mbiemri
BAJAMELA LALA





Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KERKIMIT


Numri i Rezultatit të kerkimit: D-20250114165140248
Data e Rezultatit të Kerkimit: 14.01.2025
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 16:51:40
Lloji i Kerkimit: **Emri i Personit Fizik**
Numri i Dokumentit: D-400-608-4524

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

REZARTA ENVER BYTYÇI

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



B. Keta
Bayamela Lala